

## Parashkolla dhe shkolla në komunën e Hässleholm-it

Administrata për fëmijë dhe arsim është përgjegjëse për arsimin parashkollor, përkujdesin edukativo pedagogjik, shtëpitë për aktivitete të lira, shkollat fillore, gjimnazet, shkollat speciale dhe shkollat kulturore.

Kur je duke punuar apo studiuar fëmija juaj, derisa fëmija të ketë mbushur 12 vjetë, ka të drejtë për vend në parashkollë, në përkujdesin edukativo pedagogjik apo në shtëpinë për aktivitete të lira. Një e drejtë e tillë sigurohet për fëmijën tënd të moshës 1-6 vjeç edhe nëse ti je punëkërkues apo je në shtëpi duke u përkujdesur për vëllain apo motrën më të vogël të fëmijës në fjalë. Për vende në parashkollë dhe në shtëpi të aktiviteteve të lira paguhet një tarifë e caktuar. Fëmijët e moshës 3 deri 6 vjeç kanë të drejtë për vend në parashkollë pa pagesë me një kohëzgjatje deri në 15 orë në javë.

Në Hässleholm gjenden 25 shkolla fillore me shtëpi përciellëse për aktivitete të lira, afër 50 parashkolla dhe gjimnaze. Shkolla fillore speciale gjenden në përbërjen e shumë shkollave fillore dhe për gjimnazistë me pengesa në zhvillim gjenden gjimnaze speciale. Të gjithë fëmijët në Suedi janë të detyruar të vijnë në shkollën fillore dhe shkolla është pa pagesë. Ti si kujdestar i fëmijës ke përgjegjësi për vijueshmërinë e fëmijës në shkollë.

Fëmija yt ka të rezervuar një vend në shkollën në afërsi të vendbanimit tuaj prej vitit kur fëmija mbush 6 vjeç. Vitin e parë fëmija vijon klasën parashkollore. Vijimi i klasës parashkollore është në baza vullnetare, po shumica e fëmijëve në Suedi marrin pjesë në veprimtarinë parapërgaditore shkollore që ofrohet nga klasa parashkollore. Prej atij viti kur fëmija mbush 7 vjeç fillon detyrimi nëntëvjeçar për vijimin e shkollës fillore.

Pas përfundimit të shkollimit fillor njeriu ka mundësi të zgjedhë një shkollë gjimnaziale ose, në rast kur njeriu është më i vjetër se 19 vjeç, një arsimim tjetër. Për të rinjtë që kanë ardhur në Suedi në moshën 16-20 vjeç në Hässleholm iu ofrohet arsimimi në Qendrat e të rinjëve. Qendra e të rinjëve është një shkollim parapërgaditor gjimnazial me theks në mësimin e gjuhës suedishte. Në Qendrën e të rinjëve nxënësit, përveç suedishtes, mund të

mësojnë edhe lëndë tjera për të arritur kompetencën e programit kombëtar për gjimnazin e të rinjëve. Për arritjen e kompetencës për gjimnazin e të rinjëve duhet të kesh notë kaluese në tetë lëndë mësimore, prej të cilave suedishtja për të huaj është lëndë e detyrueshme. Çka kërkohet për të arritur notimin mun të lxonit në këtë faqe <http://www.skolverket.se/laroplaner-amnen-och-kurser/grundskoleutbildning/grundskola/svenska-som-andrasprak>

Udhëtim pa pagesë për në shkollë ju ofrohet nxënësve varësisht nga largësia e vendbanimit nga shkolla. Si kujdestar i fëmijës ke të drejtë të zgjedhësh shkollë tjetër për fëmijën tënd, veç asaj që është më së afërmi nga vendbanimi juaj, por në këtë rast paguan vetë për transportin e fëmijës nga shtëpia në shkollë dhe anasjelltas.

Si në parashkollë ashtu edhe në shkollë shërbehet ushqim falas për fëmijë dhe nxënës. Ushqimi ka mundësi të përshtatet për ata fëmijë që nuk hanë ushqime të caktuara për arsye mjekësore apo religjioze.

Në shkollë fillore dhe gjimnaz ka motër medicinale dhe mjekë shkolle si dhe psikolog shkolle dhe kurator.

### **Rregullat e sjelljes dhe trajtimi i barabartë**

Në mënyrë që të gjithë pjesëmarrësit në shkollë të ndjehen mirë dhe të mund të zhvillohen, secila shkollë ka rregullat e sjelljes dhe një plan për trajtim të barabartë që i përfshinë personelin e shkollës dhe nxënësit.

Me ligj është e ndaluar të diskriminosh dikënd në shkollë për arsye të përkatësisë gjinore, etnike, religjioze apo për shkak të orientimit seksual apo pikëpamjeve të ndryshme të besimit, pengesave funksionale, moshës apo identitetit apo shprehjeve transseksuale.

Është gjithashtu e ndaluar të trajtojmë njëri tjetrin në mënyrë përcmuese apo me veprime poshtëruese. Në parashkollë dhe shkollë prania e dhunës është e papranueshme, pa marrë parasysh a bëhet fjalë për dhunën e formës gojore apo fizike. Ne i zgjidhim konfliktet përmes bisedimeve me njëri tjetrin. Të rriturit janë përherë në dispozicion në të gjitha rrethanat.

## **Bashkëpunimi mes shtëpisë dhe shkollës ose parashkollës**

Si kujdestar je përherë i mirëseardhur të na vizitosh në parashkollë, në shtëpinë e aktiviteteve të lira si dhe në shkollë. Bashkëpunimi mes teje dhe parashkollës/shkollës është i rëndësishëm për sigurinë dhe zhvillimin e fëmijës tënd . Në shkollë do të marrësh të dhënat për tu futur në programin kompjuterik Schoolsoft, ku për të gjetur informata si për mësimin e fëmijës tënd poashtu edhe informata të përgjithëshme për atë se çfarë ndodhë në shkollë.

Parashkolla/shkolla ka përgjegjësi për mbikçyrjen e fëmijës tënd. Nëse fëmija yt ka për të munguar nga parashkolla/shkolla ti duhet ta njoftosh mungesën e fëmijës para se të fillojë orari i ditës shkollore. Shkolla do të kontaktojë policinë ose administratën sociale nëse nuk ka sukses të lidhet me ty në rastin kur nuk keni lajmëruar mungesën e fëmijës në shkollë. Kjo është për sigurinë e fëmijës tënd dhe kjo është edhe një arsye e rëndësishme përse parashkolla/shkolla gjithmonë duhet të ketë të dhënat tua aktuale për kontaktim.

Ti do të thirresh në parashkollë/shkollë për një bisedë për zhvillimin e fëmijës, bisedë që trajton zhvillimin e fëmijës tënd drejtë atyre caqeve dhe parimeve të njohurive që e drejtojnë veprimtarinë shkollore.

Si kujdestar je përherë i mirëseardhur me vërejtjet tua. Përmes organeve bashkëvepruese të shkollës, këshillit të prindërve/shoqatës së prindërve/drejtorisë lokale, ke mundësi që së bashku me prindërit tjerë të marrësh pjesë në veprimtari dhe të ndikosh.

Nëse do të dish më shumë për shkollat dhe parashkollat e Hässleholm-it, vizito [www.hassleholm.se](http://www.hassleholm.se).

Më shumë informata për parashkollën dhe shkollën në Suedi mund të gjeni në broshurën e Entit të arsimit: *Parashkolla është për fëmijën tënd dhe Shkolla është për fëmijën tënd si dhe Shtëpia e aktiviteteve të lira është për fëmijën tënd* (Suedisht: *Förskolan är till för ditt barn och Skolan är till för ditt barn samt Fritidshemmet är till för ditt barn*)

## Mësimi i gjuhës amëtare

Një nxënësi që ka kujdestar që flet një gjuhë tjetër amëtare që nuk është suedishtja i ofrohet mësimi i gjuhës amëtare në fjalë në rast se

1. kjo është gjuha që përdoret nga nxënësi në shoqërimin e përditshëm në shtëpi, dhe
2. nxënësi ka njohuri elementare në këtë gjuhë.

Drejtori merr vendim për mësimin e gjuhës amëtare. Parakushti është që së paku 5 nxënës në komunë të kenë shprehur dëshirën të mësojnë të njëjtën gjuhë dhe të ketë arsimitarë të përshtatshëm për dhënien e mësimit në gjuhën në fjalë.

Për nxënësë që ju përkasin pakicave kombëtare vlenë rregulla se mësimi i gjuhës amëtare ofrohet edhe nëse gjuha në fjalë nuk është gjuha e shoqërimit të përditshëm dhe pa marrë parasysh numrin e nxënësve.

## Suedishtja si gjuhë e dytë

Nëse drejtori vendos atëherë suedishtja si gjuhë e dytë e zëvendëson lëndën e suedishtës për:

1. *nxënës që kanë gjuhë tjetër si gjuhë amëtare,*
2. *nxënës që kanë suedishten si gjuhë amëtare dhe që kanë ardhur nga shkolla jashtë vendit, dhe*
3. *nxënës të emigrantëve që kanë suedishten si gjuhë kryesore shoqërimi me një kujdestar.*

E drejta për mësim të suedishtës si gjuhë e dytë vlenë pa marrë parasysh nivelin e gjuhësor në të cilin gjindet nxënësi meqenëse të gjithë nxënësit kanë të drejtë në mësim duke u nisur nga parakushtet vetiake. Një notim në lëndën suedishtja si gjuhë e dytë është i barazvlefshëm me notimin në lëndën e suedishtës dhe lënda mund të mësohet gjatë gjithë shkollimit.

### **Mentorimi i studimit të gjuhës amëtare**

Mentorimi i studimit është një masë mbështetëse që shkolla mund të ndërmarrë nëse nxënësi ka nevojë për masa të tilla. Mentorimi i mësimit mund të organizohet në mënyra të ndryshme varësisht nga nevoja.